



**Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRY SHE**

THIRRJE PËR OFERTË

Kompani për shtyp të produkteve

Projekti “Treguesit e rinjë të trashëgimisë së Istogut” synon të kontribuojë në përmirësimin e njohurive të të rinjve dhe pjesëmarrjen e tyre në mbrojtjen dhe promovimin e kulturës dhe trashëgimisë së Istogut. Grupi kryesor i synuar i projektit janë fëmijët e shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Istogut. Ky projekt mundësohet nga Programi Rajonal mbi Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD dhe financohet nga Bashkimi Evropian, me bashkë-financim nga Komuna e Istogut, dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij projekti, në kuadër të cilit ka zhvilluar/hartuar 2 (dy) dokumente/katalogje.

EC Ma Ndryshe shpall thirrje përmes së cilës fton, kompanitë/konsorciumet e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për **“Shtypin e produkteve”**.

Kriteret për ofertim:

Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim:

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit; Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSH-së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së),
- Çmimin e shtypit për copë (kolor); formati A4; faqet e mbrendshme min.150gr; faqet e kopertinave min.300gr dhe të plastifikuara; secili dokument/raport është rreth 90 faqe; secili dokument/raport parashikohet të shtypet rreth 100 copë.
- Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe.

Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyrat e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ose në mënyrë elektronike në info@ecmandryshe.org deri më datë 17.08.2020, ora 15:00 me shënim: **“Ofertë për shtyp të produkteve”**

Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga kompanitë/konsorciumet, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Vetëm kompanitë/konsorciumet fitues do të informohen/kontaktohen.